Asa Rebbyna en jubdilena hajren minha. (1)

Kjo pasqyrë e fatit e Imami Xhafer Sadikut ësht fort e ndjerë dhe e vlerët në gjith botën Myslimane pse sicili fat ka mbaruar nën kuptimin e një ajeti qerimeje, po neve këtu ajetet nuk po i shkruajmë po mjaftojmë vetëm me kuptimin edhe përfundimin e fatit në gjuhën Shqipe.

Fat i parë

AAA = Imami Xhafer Sadiku urdhron: (2)

O Bilbil faqe bardhë! Me këtë fat të përgëzojmë se IMadhi ZOT (xhel-le shanuhu) ësht mprojtës' i jot në të dy botnat tue falë ty nderim e shpëtim për jetë. Në duar tënde do të hyjë pasuni me

1) Kuptimi: lusim edhe shpresojmë që i Madhi ZOT të na i kthejë punën edhe ikballë më për hajir nga kjo që jemi.

2) Ky imam është i ndjerë në gjith botën Myslimane dhe e dashurojnë gjith sektet Islam po ata që thonë e dashurojmë Imami Xhafer Sadikut duhet të punojë si ai zotni që falesh dhe agjëron ditë e natë.

dobi edhe do të çilen gjith portat e hajirit edhe puna jote do të bëhet e uruar edhe bijtë t'ënt bëhen të bekuar edhe nga gjith belatë je i shpëtuar edhe dëshirat i ke të mbaruara me sa je në rrugë të mbarë. Inshaell-llahu teala d. m. th. në dasht ZOTI.)

2) AAB = Imami Xhafer Sadiku urdhnon: O Bilbil i fatit të hajirit! Ti shëmllen si bujku që mbjell një farë e gjen shtatë kallinj. E çdo kalli sa thrime ka ashtu edhe nderi, pasunija jote shtohet, armiqët t'uej dërmohen, dëshirat t'ënde mbarohet (inshaell-llahu teala. Pra: qëndro e vazhdo në rrugë të drejtë).

3) A.A.Xh. = Imami Xhafer Sadiku urdhnon: O çilsi i fatit! Ti atë qëllim që ke largoje edhe Sadakanë shtoje e në këto dit bëj durim që të përqafosh gëzimin (inshaell-llahu teala).

4) A.A.D. = Imami Xhafer Sadiku urdhnon: O bilbil fatmath! ti ke armik që përpiqen për keq po i Madhi ZOT qëllimet edhe keqpunimet e tyre i shuan e ty të mpron. Lajmëtari Hazreti Isaj — për mrekulli — kur ngjalli të vdekurit si dolli

(*Besimtar! Kur do herë bëju dashamir edhe punë mirë që të bëhesh Fat-mirë në të dy jetë: se për ndryshe je fatzi, jo me dëm jo me hidhrim e shpirtit t'ënd. Kur të prishet një sent a një kafshë, dije se kjo vjen nga zullumi që i ke bërë tjatrit*).